

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/01/23

Datë: 27.01. 2023

Në bazë të nenit 40.2 germa (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 35 pika 35.1 dhe neni 39 pika 39.1 të Statutit të Komunës së Junikut, në mbështetje të nenit 4 pikat 1,2,3,4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë, raportit me propozime nga paneli përzgjedhës, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.27.01.2023, mori vendim për themelimin e Komitetit Konsultativ të Përsoneve me Aftësi të Kufizuara, në bazë sa u cek më lartë nxjerr këtë:

V E N D I M

**PËR THEMELIMIN TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E JUNIKUT**

- I. Themelohet Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Junikut në këtë përbërje:
 1. Beqë Knushi,
 2. Imer Hoxha,
 3. Marigona Pepshi,
 4. Ryve Hoxha,
 5. Bujar Maloku,
 6. Arjeta Shala,
 7. Albulena metaj
- II. Kryesuesi i Kuvendit e fton takimin e parë të Komitetit, në të cilin takim Komiteti e zgjedh kryesuesin, nga radhët e veta.
- III. Kompetencat dhe mënyra e organizimit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.01/2016.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit.


V. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL ,
- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Të përmendurit në pikën I,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/02/23

Datë: 27.01.2023

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); neneve 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Ligji Nr. 03/L-049, GZRK numër 27/2003) dhe Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.01.2023, nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e
Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale

- I. Me këtë vendim miratohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale /në tekstin e mëtejme Rregullorja/.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja e miratuar nga pika I. e këtij vendimi.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:



1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit

z. Shpejtim Gacaferi



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947
<http://rks-gov.net/junik>



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/03/23

Datë: 27.01.2023

Në pajtim me nenin 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër-komunal, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e regullt të mbajtur me datë: 27.01.2023, miraton:

V E N D I M

Për bashkëpunim ndër-komunal - ndërkombëtar

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Junikut për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal ndërkombëtar.
2. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim:
 - 2.1. Komuna e Junikut dhe,
 - 2.2. Komuna e **Nuthe Urstromtal në Gjermani**.
3. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet për përgatitjen e propozim marrëveshjes/s; për bashkëpunimin ndër-komunal ndërkombëtar.
4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/04/23;
Datë: 27.01.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për formimin e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut

I. Me këtë vendim formohet Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut.

II. Komisionin e perbejne 7 anetarë . Kater nga radhet e kuvendit një nga radhet e ekzekutivit dhe një nga shoqëria civile (OJQ-të).

1. **Nga radhet e kuvendit:** Sadri Krasniqi,
Zenel Maloku,
Xhemë Tofaj,
Shpejtim Gacaferi,
2. **Nga ana e ekzekutivit:** Leonora Shehu - Drejtoreshë e Administrates,
3. **Nga shoqëria civile:** Safete Shehu – OJQ- Qershiza,
4. **Një nga ana e seciles bashkesi lokale, apo fshat.**

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Të apostrofuarit në pikën II;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAFERI

Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/05/23;
Datë: 27.01.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për formimin e Komisionit për shqyrtim të ankesave lidhur me zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut

I. Me këtë vendim formohet Komisioni për shqyrtim të ankesave lidhur me zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut.

II. Komisionin e perbejne 3 (tre) anetarë nga radhet e Kuvendit.

1. Mursel Salihaj – anëtar nga LDK,
2. Erleta Qestaj – anëtare nga AAK,
3. Eliza Pepshi – anëtare nga LVV,

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.


Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Të apostrofuarit në pikën II;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAFERI


Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/06/23;
Datë: 27.01.2023 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për hapjen e diskutimit publik për miratimin e Rregullores Edukativo - Arsimore (leximi i parë);

I. Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për miratimin e Rregullores Edukativo - Arsimore në lexim të parë.

II. Rregullorja nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.

III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.

IV. Ekspozimi i Rregullores do të bëhet në zyrën e personelit të objektit të Komunës së Junikut.

V. Diskutimi publik i Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 15.02.2023 dhe përfundon më: 10.03.2023).

VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Rregullorja ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.

VII. Diskutimi publik i Rregullores organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Zyra e DAKRS-së të Komunës së Junikut.

VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj Rregulloreje.

IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Zyra e Kryetarit të Komunës.

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Arsim, kultur, rini e sport;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAFERI

kryesues





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/07/23;
Datë: 27.01.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), neni 11 i Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Rregulloren Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorive të ndërmarrjeve rajonale të ujit dhe Rregullore (QRK) nr. 19/2015 për bdryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave borde të drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, neni 14 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), të nenit 10 shkronja f), të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për Nisjen e Procedurave për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL), në Junik

I. Miratohet Vendimi për Nisjen e Procedurave për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL), në Junik.

II. Qëllimi i Themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Junik është që të menaxhohen dhe mirëmbahen hapësirat publike në komunën e Junikut.

III. Komuna e Junikut viteve të fundit është duke bërë hapa të dalueshme në rregullimin e infrastrukturës Publike me rrugë të reja, ujësjellës dhe kanalizim, rregullimin e hapësirave publike, gjelbërimin e hapësirave publike të qytetit të cilat kërkojnë edhe mirëmbajtje dhe ruajtjen e këtyre investimeve në dobi të qytetarëve.

IV. Me themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale synojmë që këto shërbime dhe përkujdesje të jenë të menaxhuara në mënyrë ma të mirë të mundshme.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;


3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAFERI



Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/08/23;
Datë: 27.01.2023

Në bazë të nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), Udhëzim, i Administrativ (MAPL) Nr.02/2018, nenit 39 paragrafi 39.1 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

V E N D I M
formimin e Komitetit për Shërbime Publike

- I.** Me këtë vendim formohet Komiteti për Shërbime Publike / në tekstin e mëtejme Komiteti/.
- II.** Komiteti është trup ndihmës i kuvendit të komunës dhe punon për dhe në emër të kuvendit të komunës.

III. Komiteti e përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve . Tre (3) nga radhet e kuvendit të komunës së Junikut të cilët propozohen në kuvend (nga një antar nga secili grup i partive politike të përfaqesuara në kuvend), dy anëtarët e tjer të propozuar mundësisht duhet të jenë ekspert të fushës së shërbimeve publike.

- 1. Nga radhet e kuvendit: Lirjeta Shehu – anëtare LDK**
Festina Maloku – anëtare AAK
Eliza Pepshi – anëtare LVV
- 2. Nga radhet e eksperteve: Xhemë Xhuli – ing. ndertimtarisë**
Etnik Shala – ing. Arkitekturës

IV. Përbërja e komitetit duhet të reflektojë barazi gjinore.

V. Komiteti është organ këshillëdhënës, kurse për punën e tij i përgjigjet kuvendit të komunës.

VI. Përgjegjësitë e komitetit janë të përcaktuara me nenin 4 të Rregullores për punën e komiteteve të kuvendit të komunës së Junikut.

VII. Kompenzimi financiar i anëtarëve të komitetit bëhet në përputhje me nenin 4 paragrafi 4.4 të Rregullores për punën e komiteteve të kuvendit të komunës së Junikut.

VIII. Mbajtja e mbledhjes konstituive dhe zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet në përputhje me nenin 8 të rregullores për punën e komiteteve të kuvendit të komunës së Junikut.

IX. Komiteti mbrenda një viti kalendarik duhet të mbajë së paku 4 (kater) mbledhje të rregullta.

X. K

XI. Komiteti brenda një viti kalendarik sipas nevojës mund të mbajë edhe më shumë se 4 (katër) mbledhje të rregullta por mbledhjet e tjera të komitetit nuk kompensohen financiarisht.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Të apostrofuarit në pikën III;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAFERI





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/09/23 ;
Datë: 27.01.2023 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), dhe në bashkërendim me udhëzimet administrative në fuqi, nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e procedurave për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut

- I.** Me këtë vendim fillohet procedurat për hartimin e (projekt) Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut, tekstin e mëtejme/ (projekt) Rregullore/.
- II.** Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të projekt – Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut .
- III.** Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
- IV.** Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V.** Obligohet Kuvendi i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI.** (Projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII.** Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII.** Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Sherbime Publike e Komunës së Junikut.

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Sherbime Publike
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim GACAFERI
kryesues

